



Raporti i Performancës

Bashkia Libohovë

2025




Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS



Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	5
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	7
Kategoria: Shërbimet	8
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	9
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	16
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	22
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	28
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	35
Menaxhimi i mbetjeve	43
Përkujdesi Social	49
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	54
Shërbimet Publike Vendore	59
Rrjeti rrugor rural	68
Transporti publik	78
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	80
Kategoria: Mirëqeverisja	2
Burimet Njerëzore	3
Kategoria: Menaxhimi Financiar	7
Të Ardhurat	8
Buxheti	13
Shpenzime	16



Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”, i cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky proces reformash, i shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji “Për financat vendore” (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale.

Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi i performancës në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura përmes një procesi konsultues me ekspertë tematikë.



Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Strategjia e zhvillimit e Bashkisë Libohovë synon promovimin e zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm, duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe turizmin, veçanërisht turizmin kulturor dhe natyror. Ajo përqendrohet gjithashtu në përmirësimin e infrastrukturës lokale, shërbimeve publike dhe kushteve të jetesës për banorët, si dhe në mbështetjen e biznesit të vogël dhe mesëm. Një fokus i veçantë është ruajtja e trashëgimisë historike dhe kulturore të zonës, duke kombinuar zhvillimin ekonomik me ruajtjen e identitetit lokal.

Rajoni Jugor ku përfshihet edhe zona e Libohovës gjendet në jug të vendit dhe ka dalje të gjerë në detin e ngrohtë të Jonit. Kjo pozitë gjeografike kushtëzon tiparet më të shprehura mesdhetare të klimës, të hidrografisë dhe të bimësisë së zonës e rajonit. Klima është tipike mesdhetare, me dimër pothuajse të butë dhe të lagësht dhe me verë të nxehtë dhe shumë të thatë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit lëviz nga 7,8-12 gradë C. Sasia vjetore mesatare e rreshjeve arrin 1600 mm reshje shiu. Në këtë zone bien të gjitha llojet e rreshjeve: shi, breshër, bore dhe brymë. Libohova kufizohet në veri me Bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me Bashkinë Dropull dhe në perëndim me Bashkinë Gjirokastrë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Libohovës.



Bashkia e re e Libohovës ka nevojë për investime në infrastrukturë, ekonomi, turizëm, bujqësi e blegtori, pasi është një nga zonat më të rëndësishme për numrin e bagëtive të imta dhe sipërfaqes bujqësore. Libohova dhe e gjithë zona e saj mban rekord në Shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale. Pozicioni gjeografik e bën Libohovën dhe zonën përreth saj një qendër potenciale, e cila mund të ofrojë një shërbim më të mirë si qendër bashkie, duke shfrytëzuar potencialet hidrike, bujqësore, blegtorale dhe turistike të të gjithë zonës. Administrimi i të ardhurave nga bujqësia, nga blegtoria, fuqizimi dhe nxitja e bizneseve dhe promovimi i produkteve të zonës mbeten sfida të rëndësishme për t'u përballuar nga Bashkia e re e Libohovës.



Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

Popullsia e Bashkisë Libohovë është kryesisht e shpërndarë në zonat rurale, me një pjesë më të vogël të përqendruar në qytet. Banorët angazhohen kryesisht në bujqësi, blegtori dhe aktivitete të vogla tregtare, ndërsa emigracioni ka ndikuar në reduktimin e popullsisë aktive. Megjithatë, lidhja me vendlindjen ruhet përmes rikthimeve periodike dhe investimeve familjare në komunitet.



Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.


Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.



Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015, i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik, kopshtet. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financiar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit. Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore, dhe raporti fëmijë-mësues.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.


Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
NR.1 Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësimor në arsimin parashkollor	4.75	5	5	15	15	15
NR.2 Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	7.25	5.9	7.2	5.81	5.81	5.81
NR.3 Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë	23	11.8	15.6	14.76	14.76	14.76
NR.4 Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor	Raporti në % i numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve 3 - 6 vjeç	47.83	51.05	69.23	50	50	50



Treguesi nr. 1

Të dhënat për numrin mesatar të fëmijëve për një mesues të arsimit parashkollor tregojnë një tendencë në rritje. Në 2022, numri i regjistrimeve ishte 19 kundrejt 4 mesuesve të arsimit parashkollor, pra një mesatare 4.75 fëmije për cdo mesues. Gjatë 2023, ky numër shkoi në 20, duke shënuar një rritje të lehtë, pra mesatarja fëmije/mesues ishte 5. Në vitin 2024, regjistrimet vazhduan të qendrojnë kontante, pra 20 fëmije të rregjistruar. Për 2025 kemi një rritje të mëtejshme të numrit të regjistrimeve që arrin në 46, pra mesatarja fëmije/mesues është 15. Të dhënat për vitet 2026 dhe 2027 nuk janë të disponueshme, gjë që sugjeron se duhet pritur për të kuptuar më mirë trendin. Me poshte janë ilustruar keto të dhëna edhe me grafike.


Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mesimor në
arsimin parashkollor për vitet 2022-2027.





Treguesi nr.2

Te dhenat per nr.mesatar te nxenesve per cdo punonjes mesimor tregohen me disa ulje-ngritje ne vite.Konkretisht per vitin 2022 kemi 232 nxenes qe ndjekin arimin baze dhe mesues qe sherbejne ne arsimin baze jane 32,pra mesatarja nxenes/mesues eshte 7.2 .Per vitin 2023 kemi nje mesatare 5.9 (154nxenes/26 mesues).Per vitin 2024 kemi nje rritje te raportit nxenes mesues me nje mesatare 7.2 (204 nxenes/28 mesues). Viti 2025 shenon nje renie duke e cuar mesataren ne 5.81 (192 nxenes/33 mesues)






Treguesi nr.3

Te dhenat per nr.mesatar te nxenesve ne nje klase tregojne nje tendence me disa ulje-ngritje.Per vitin 2022 kemi nje numer mesatar prej 23 nxenes per cdo klase (232 femije/10 klase).Viti 2023 ka mesatare prej 11.8 nxenes per cdo klase(154 nxenes/13 klase).Viti 2024 ka rritje te mesatares prej 15.6 nxenes (204/13).Ne vitin 2025 kemi nje renie te lehte te mesatares deri ne 14.7 nxenes per cdo klase (192/13).

Me poshte jane ilustruar me grafike keto te dhena.






Treguesi nr.4

Per sa I perket raportit ne perqindje te numrit te femijeve qe frekuentojne sistemin parashkollor kundrejt numrit total te femijeve 3-6 vjec,te dhenat jane si me poshte: Viti 2022 ka nje perqindje te frekuentimit prej 47.8% ,viti 2023 ka nje perqindje prej 51.05%,viti 2024 shkon ne 69.23 % dhe viti 2025 arrin ne nje frekuentim prej 50%.Shifrat e viteve 2026 dhe 2027 nuk jane te disponueshme por jane vendosur duke u bazuar ne vitin e fundit te raportimit pra 2025.

Me poshte paraqitja grafike.





Të dhënat e shërbimit


Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	19	20	20	46	46	46
Klasa në sistemin e arsimit bazë	10	13	13	13	13	13
Klasa në sistemin parashkollor	3	3	3	2	2	2
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit bazë	32	26	28	33	33	33
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor	4	4	4	3	3	3
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	232	154	204	192	192	192
Ndërtesa funksionale të arsimit bazë dhe parashkollor	7	7	7	7	7	7
Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç rezident në territorin e bashkisë	38	45	39	46	46	46
Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të meremetuara në vit	0	4	2	1	1	1
Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të përmirësuara / mirëmbajtura në vit	7	7	7	7	7	7



Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve dhe ndërtesave të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke përfshirë shkollat profesionale, si dhe shpenzimet për pagat e stafit mbështetës. Kjo përfshin gjithashtu administrimin, organizimin e inspektimit të shërbimeve në konvikte, për strehimin dhe ofrimin e vakteve ushqimore për nxënësit.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
NR.1-Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	6.1	5	4.5	7.25	7.25	7.25
NR.2-Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e mesme	Raporti në % i shkollave të mesme të mirëmbajtura kundrejt ndërtesave funksionale të arsimit të mesëm në total	100	100	100	100	100	100




Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Treguesi nr.1

Mesimi ne klasat e arsimit te mesem zhvillohet sipas standartit kombetar.

Per vitin 2022 kemi nje numer mesatar nxenesish prej 6.1 nxenes per cdo mesues.Viti 2023 ka shenuar nje renie ne 5 nxenes per cdo mesues dhe po ashtu edhe viti 2024 ka aritur deri ne 4.5.Viti 2025 shenon nje rritje disi te ndjeshme duke arritur deri ne 7.25 nxenes per cdo mesues te arsimit te mesem.Synohet qe ne dy vitet e ardhshme te arrijme ne shifra akoma edhe me te kenaqshme.

Si me poshte paraqitja grafike e ketij treguesi.






Treguesi nr.2

Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e mesme

Raporti në % i shkollave të mesme të mirëmbajtura kundrejt ndërtesave funksionale të arsimit të mesëm në total

Raporti në % i shkollave të mesme të mirëmbajtura në bashkinë Libohovë ka treguar një qëndrueshmëri të lartë. Për **vitin 2022**, shkolla e mesme përgjithshme është mirëmbajtur në masën **100%**. Ky trend i qëndrueshëm vijon edhe për **vitin 2023** dhe **2024**, ku raporti mbetet gjithashtu **100%**. Edhe për vitet e ardhshme, **2025**, **2026**, dhe **2027**, mbetet konstant në **100%**. Kjo tregon një angazhim të vazhdueshëm për mirëmbajtjen optimale të infrastrukturës së arsimit të mesëm. Qëndrueshmëria në mirëmbajtje është një indikator pozitiv për cilësinë e arsimit në këtë bashki. Përkushtimi për të siguruar kushte të mira fizike reflekton një prioritet të lartë për arsimin nga autoritetet lokale. Rritja e standardeve të mirëmbajtjes kontribuon në një mjedis më të favorshëm për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Në mënyrë të përgjithshme, këto të dhëna pasqyrojnë përkushtimin për të ruajtur cilësinë e infrastrukturës arsimore në Libohovë.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Klasa në sistemin e arsimit të mesëm	3	3	3	3	3	3
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm	6	7	7	4	4	4
Ndërtesa funksionale të arsimit të mesëm	1	1	1	1	1	1
Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	37	35	32	29	29	29
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9 vjeçar)	25	17	15	33	30	26
Objekte të arsimit të mesëm të meremetuara në vit	1	1	0	0	0	0
Objekte të arsimit të mesëm të përmirësuara / mirëmbajtura në vit	1	1	1	1	1	1



Më poshtë paraqiten disa të dhëna për nxënësit e regjistruar në vite, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm

Të dhënat për nxënësit e regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm në Bashkinë Libohovë tregojnë një ndryshueshmëri të theksuar gjatë periudhës së analizuar. Në **2022**, numri i nxënësve të regjistruar ishte 37, ndërsa në **2023** pati një rënie deri në **35** nxënës. Kjo rënie mund të reflektojë sfida të ndryshme, si zhvendosja demografike apo faktorë të tjerë social-ekonomikë. Në **2024**, numri i nxënësve regjistroi serish një rënie deri në 32. Për vitin **2025**, numri shkoi deri në **29**. Mendojme që vitet **2026** dhe **2027** të arrijmë në një stabilitet me të mirë për sistemin arsimor të mesëm.





Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shërbimi i ujitje-kullimit përfshin mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore u transferuan bashkive në vitin 2016. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të oftojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahësueshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Përmirësimi i rjetit ujtiës	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rjetit total të kanaleve ujtiëse në pronësi të bashkisë (në %)	6.6	6.6	10	10.47	10.47	10.47
Përmirësim i rjetit kullues	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	11.1	11.1	16.6	16.6	16.6	16.6



Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.


Treguesi nr.1

Përmirësimi i rrjetit ujitës

Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)

Të dhënat për bashkinë Libohovë për vitet 2022 dhe 2023 tregojnë një përqindje prej 6.6% km kanal vaditës të pastruar në krahasim me rrjetin total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë. Në vitin **2024**, përqindja e tyre ishte 10%, duke treguar një rritje relativisht të mirë në pastrimin e kanaleve. Në **2025**, përqindja shkoi në 10.47%. Në 2 vitet e ardhshme synojmë të kemi një performancë akoma më të mirë për pastrimin e rrjetit ujites.

Krahasimi mes viteve të ndryshme tregon se ka patur përmirësime për efektivitetin e sistemit ujitës në bashkinë Libohovë por gjithmone ka sfida të cilat lidhen kryesisht me kufizime financiare apo logjistike.






Treguesi nr.2

- **Përmirësim i rrjetit kullues**

Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)

Të dhënat për bashkinë Libohovë ne mirembajtjen e rrjetit të kanaleve kulluese tregojnë një përqindje kontante prej 11.1% për vitet 2022 dhe 2023. Në vitin **2024** janë pastruar **16.6%** e rrjetit total të kanaleve kulluese. Kjo përqindje qëndroi konstante edhe për vitin 2025. Këta tregues japin një angazhim më të fortë të bashkisë në përmirësimin e infrastrukturës së rrjeteve kulluese. Pastrimi i kanaleve është jetik për shmangien e përmbytjeve dhe ruajtjen e tokave bujqësore. Këto përmirësime tregojnë një fokus të vazhdueshëm në menaxhimin e pasurive natyrore për mirëqenien e komunitetit. Megjithatë ka pasur përmirësime, ka vend për rritje të mëtejshme në shkallën e pastrimit të kanaleve.

Si me poshte paraqitja grafike.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	72	72	72	72	72	72
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	42	42	42	42	42	42
Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	400	600	600	600	600	
Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	2.8	2.8	4.2	4.4		
Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km	8	8	12	12		
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	1100	1100	1100	1100		
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	470	470	470	500		



Më poshtë paraqiten me grafikë disa te dhena te tjera.

📌 *Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit*


Për vitin **2022**, numri i familjeve fermere në Bashkinë Libohovë që përfitonin nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit ishte 400. Një ritje e theksuar u vu re në **2023**, ku ky numër u zmadhua duke shkuar në **600** familje. Shifrat e familjeve perfituese qendrojnë konstante edhe për vitet 2024 dhe 2025. Ritja nga **2022** në **2025** është veçanërisht mbresëlënëse, duke sugjeruar një investim apo përmirësim të infrastrukturës. Stabiliteti nga **2023** e në vazhdim është një tregues pozitiv për vijimësinë e shërbimit. Kjo ndryshueshmëri mund të jetë pasojë e politikave të reja mbështetëse ose zhvillimit të infrastrukturës për këto shërbime. Në përgjithësi, mund të vërehet një tendencë rritëse që reflekton përmirësime në shërbimin ndaj fermerëve në Libohovë.





Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe afrim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimin e shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mbikqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e licencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrole të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Nr.1 Rritja e kapaciteteve të punonjësve për inspektime	Numër inspektimesh për punonjës	6.6	6.6	7.3	7.3	7.3	7.3
Nr.2 Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullor	Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota	5.7	5.7	6.3	6.3	6.3	6.3
Nr.3 Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullor	Numri i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota	0.86	0.86	0.86	0.86	0.86	0.86




Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Treguesi Nr.1

- **Rritja e kapaciteteve të punonjësve për inspektime**

Numër inspektimesh për punonjës

Të dhënat e bashkisë Libohovë për numër inspektimesh për punonjës tregojnë një prirje në rritje. Në vitin **2022**, numri i inspektimeve për punonjës ishte 6.6. Në vitin **2023**, ky numër vazhdon të jete ne te njejtat shifra,pra **6.6 inspektime per cdo punonjes**.Në **2024**, pati një rritje të mëtejshme në **7.33** inspektime për punonjës. Viti **2025** vazhdoi me të njëjtën normë prej **7.33** inspektimesh, duke sugjeruar përmirësim të vazhdueshëm në mbikëqyrje. Kjo normë e pandryshuar prej **7.33** pritet të ruhet edhe për vitet **2026 dhe 2027**. Kjo rritje graduale tregon përpjekjet e bashkisë për të rritur vëmendjen dhe disiplinën në punë. Përmirësimi i vazhdueshëm nga **2022** deri më **2027** pasqyron zhvillimin organizativ dhe synimin për standarde më të larta të inspektimit.






Treguesi Nr.2

- **Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullor**

Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota

Të dhënat për numrin e kontrolleve dhe inspektimeve për **1000 ha** pyje dhe kullota në Bashkinë Libohovë tregojnë një trend rritës gjatë periudhës së raportuar. Në vitin **2022 dhe 2023**, numri i kontrolleve dhe inspektimeve ishte 5.7. Kjo vlerë u rrit në 6.3 në vitin **2024**, duke mbetur e pandryshuar në të njëjtën vlerë edhe për vitin **2025**. Ky numër supozohet të mbetet konstant edhe për vitin **2026 dhe 2027**. Rritja nga **2022 në 2025** ishte me 0.6. Vendosja e vlerave në një nivel të qëndrueshëm prej **6.3** për dy vite radhazi tregon një stabilizim në numrin e kontrolleve dhe inspektimeve. Me poshte paraqitja grafike e këtij treguesi.






Treguesi Nr.3

• Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullor

Numri i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota

Të dhënat e bashkisë Libohovë për numrin e punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota tregojnë një stabilitet të plotë gjatë gjithë periudhës së analizuar. Në vitet **2022, 2023, 2024, 2025, 2026,** dhe **2027**, vlera ka qëndruar konstant në **0.86**. Ky numër i qëndrueshëm sugjeron se bashkia ka patur një planifikim të vazhdueshëm për menaxhimin e burimeve natyrore. Stabiliteti në këto vlera tregon se aftësitë administrative për pyjet dhe kullotat janë të qëndrueshme në këtë bashki. Një qëndrueshmëri e tillë sjell besim në mënyrën se si menaxhohen këto zona nga ana e bashkisë. Kjo mund të nënkuptojë gjithashtu se bashkia ka arritur një ekuilibër të qëndrueshëm në ndarjen e burimeve të punës. Është e mundur që këto shifra të reflektojnë një strategji të qëndrueshme për punësimin. Gjithashtu, mund të nënkuptojë se kërkesat për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e pyjeve dhe kullotave nuk kanë ndryshuar. E rëndësishme është që vlerat e punonjësve nuk janë ulur, çka tregon për një angazhim të vazhdueshëm ndaj këtyre zonave natyrore.



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Numri i punonjësve për menaxhimin pyjësor dhe kullotave	3	3	3	3	3	3
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullësor (në ha)	3474	3474	3474	3474	3474	3474
Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullësor	20	20	22	22	22	22
Numri i pemëve të reja të mbjellura në fondin pyjor në vit	1000	100	100	0	-	-



Më poshtë paraqitet një prej të dhënave të shërbimit, e shoqëruar me grafikun përkatës.

✦ *Numri i kontrolleve dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor*

Në bashkinë Libohovë, numri i kontrolleve dhe inspektimeve të fondit pyjor dhe kullosor ka shfaqur një rritje dhe stabilizim në vitet e fundit. Në **2022**, janë realizuar gjithsej 20 kontrolle dhe inspektime. Vitin e mëpashtëm, **2023**, pati serish 20 kontrolle . Në **2024**, numri shkoi në 22 inspektime. E njëjta shifer raportohet edhe për vitin 2025. Stabilizimi i kontrolleve në 22 tregon për një përkushtim të vazhdueshëm nga autoritetet për të monitoruar dhe mbrojtur fondin pyjor dhe kullosor. Kjo tregon për një politikë të qëndrueshme të mbikëqyrjes së burimeve natyrore në zonën e Libohovës. Ky trajekt pritet të ndihmojë në ruajtjen dhe menaxhimin efektiv të fondit pyjor dhe kullosor të rajonit. Përmirësimet në proceset e vëzhgimit mund të kontribuojnë në përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve të rëndësishme natyrore.





Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Funksioni i menaxhimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi iu transferua Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 2016. Në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, deri në fund të vitit 2018 u ngritën stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, secili me një strukturë minimale prej 14 punonjësish. Analiza e këtij shërbimi mbështetet kryesisht në dy tregues kryesorë: numrin e zjarrfikësve për çdo 1.500 banorë dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10.000 banorë. Në nivel kombëtar, raporti aktual është afërsisht një zjarrfikës për 1.500 banorë. Një tendencë e ngjashme vërehet edhe në aspektin e mjeteve zjarrfikëse, ku disponueshmëria e tyre bie në raport me rritjen e madhësisë së bashkive. Bashkia është përgjegjëse për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimin në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.





Treguesit e shërbimit


Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Nr.1-Rritja e sipërfaqes së mbuluar me shërbim për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin	Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin ndaj sipërfaqes totale të bashkisë	100	100	100	100	100	100
Nr.2-Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH	Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë	481280 3.2%	481280 3.2%	624225 3.35%	453885 2.2%	453885 2.2%	453885 2.2%
Nr.3-Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës	Zjarrfikës të trajnuar/zjarrfikës total (në %)	57.1	100	100	100	100	100
Nr.4-Sipërfaqe e mbuluar me shërbim ndaj numrit të makinave zjarrfikëse	km2 / numrit të makinave zjarrfikëse	248	248	248	248	248	248



Treguesi NR.1

Per sa I perket raportit ne perqindje te sip.se mbuluar me sherbim per shuarjen e zjarrit dhe shpetimin ndaj sipërfaqes totale te bashkise,ky sherbim sigurohet ne 100% te territorit te bashkise.






Treguesi NR.3

Ritija e kapaciteteve te punonjeseve zjarrfikes.

Ne vitin 2022 kemi 14 punonjes ne total dhe vetem 8 prej tyre jane te trajnuar ,pra raporti ne % eshte 57.1 % zjarrfikes te trajnuar.

Ne vitet e ardhshme ka ndodhur nje rritje deri ne 100 % punonjes zjarrfikes te trajnuar.Kjo tregon nje angazhim te madh ne pajisjen me njohuri dhe aftesi menaxhuese per zjarret,ne te gjithe stafin e MZSH-se.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatarja ditën dhe natën)	60	60	60	60	60	60
Mësime treguese për përballimin e rasteve të zjarrit në shkolla, institucione publike, etj	2	3	3	0		
Numri i stacioneve MSZH	1	1	1	1	1	1
Numri i makinave zjarrfikëse në punë	1	1	1	1	1	1
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	14	14	14	14	14	14
Zjarrfikës në dispozicion	12	12	12	12	12	12
Sipërfaqja gjithësej e bashkisë	248 km ²	248	248	248	248	248
Total shpenzime për mzsh (në lekë)	14631000	17532000	18611000	20511000		
Fikese zjarri të kolauduara dhe të vendosura në institucione	3	5	5	9		
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimi nga MZSH	40	40	45	33		
Sipërfaqja e mbuluar me shërbimin e fikjes së zjarrit dhe shpëtimi (në km ²)	248	248	248	248	248	248
Inspektime tek të tretët	0	0	0	0		
Zjarrfikës të trajnuar	8	14	14	14	14	14



Më poshtë paraqitendisa prej të dhënave të shërbimit, të shoqëruara me grafikët përkatës.


Total shpenzime për mzsh (në lekë)

Në vitin **2022**, bashkia Libohovë raportoi një total shpenzimesh për mzsh në vlerën 14.631.000 **lekë**. Në **2023**, shpenzimet pësuan një rritje të konsiderueshme, duke arritur në 17.532.000 **lekë**. Viti **2024** pati serish rritje të ndjeshme të shpenzimeve në 18.611.000 **lekë**. Për vitin **2025**, ka ndodhur një tjetër rritje deri në vlerën që arrin 20.511.000 **lekë**. Rritja nga viti **2022** në **2025** mund të jetë pasojë e faktorëve të brendshëm ose të jashtëm që ndikuan buxhetin. Rritjet tregojnë përpjekje të suksesshme të rimëkëmbjes financiare.



Fikese zjarri të kolauduara dhe të vendosura në institucione

Të dhënat e bashkisë Libohovë për fikëset e zjarrit të kolauduara dhe të vendosura në institucione tregojnë një rritje. Në **2022**, shkalla e vendosjes së fikëseve të zjarrit ishte vetëm 3 njësi, duke treguar ndoshta një fillim të ri për përmirësimin e nevojave. Në **2023 dhe 2024**, kemi 3 njësi, që tregojnë përpjekje për përmirësim. Në **2025**, numri rritet në 9. Përmirësimet nga **2022** në **2025** janë veçanërisht domethënëse, duke treguar nevojën e zgjerimit të mëtejshëm të masave të sigurisë.




✱ Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH

Të dhënat për rastet e menaxhuara nga MZSH në Bashkinë Libohovë për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit tregojnë një tendencë të qëndrueshme me disa ndryshime në vite. Në **2022**, numri i rasteve të menaxhuara ishte 40, duke treguar një aktivitet të lartë në atë vit. Në **2023**, serish numri është në **40** raste. Viti **2024** pati një rritje të rasteve deri në **45** raste. Për vitin **2025**, rastet u zvogeluan dhe arritën në 33. Zvogelimi i rasteve të zjarrit është edhe një tregues që ka bërë direkt me ndergjegjesimin e qytetarëve për rreziqet nga zjarri. Në përgjithësi, numri i rasteve të menaxhuara ndryshon modestisht, duke nxjerrë në pah rëndësinë e monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të protokolleve të reagimit dhe masave parandaluese. Të dhënat tregojnë nevojën për vlerësim të mëtejshëm të politikave të mbrojtjes nga zjarret dhe efektivitetit të tyre. Përpjekjet për të mbajtur rastet në një nivel më të ulët duhet të vazhdojnë për të siguruar një mjedis më të sigurt për qytetarët e Libohovës.



Raste te menaxhuara per shuarjen e zjarrit dhe shpetimit nga MZSH.





Menaxhimi i mbetjeve

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, bashkitë kanë detyrimin për administrim, mbikëqyrjen, inspektimin, organizimin ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; administrimin e granteve, huave ose financimeve për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; pastrimin e rrugëve, parqeveve etj. Ky funksion përfaqëson një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të bashkisë, me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahaseshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
NR.1-Rritja e territorit të mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbejteve	Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbejteve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	20.16	41.7	41.7	41.7	41.7	41.7
Nr.2-Rritja e mbulimit të shërbimit e menaxhimit të mbejteve	Raporti në % i popullsisë së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbejteve ndaj popullsisë totale të bashkisë	74.4	36	36	36	36	36



Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.


Treguesi Nr.1

- **Rritja e territorit të mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve**

Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë

Bashkia Libohovë, sipas të dhënave të paraqitura, ka hasur një rritje të ndjeshme në proporcionin e sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale. Në **2022**, kjo përqindje ishte 20.16 %, tregues që reflektonte një mbulim relativisht të mirë të territorit me shërbime mbetjesh. Në vitin **2023**, shifra shenon një rritje shume të ndjeshme deri në 41.7% të territorit ku ofrohet ky shërbim. Ky nivel i mbulimit mbetet konstant edhe për vitet në vijim pra 2024 dhe 2025. Kjo tregon një stabilizim, dhe një nivel të mirë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Mangësitë në shërbim mund të kenë implikime serioze për mjedisin dhe jetesën e komunitetit të Libohovës. Nevoja për masa përmirësuese është e domosdoshme për të garantuar një menaxhim më të mirë të mbetjeve në të ardhmen. Gjithashtu duhet të synohet që të mbulohet me shërbim akoma me shume nga sipërfaqja totale e bashkisë edhe pse gjatë viteve kjo sipërfaqe është dyfishuar duke shkuar deri në 41.7 %.

Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sip. totale të bashkisë.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Sipërfaqja gjithësej e bashkisë	248	248	248	248	248	248
Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeje	5200	2500	2500	2500	2500	2500
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeje në km ²	50	103	103	103	103	103
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeje në zonat rurale (ditë në javë)	2	5	3	3	3	3
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeje në zonat urbane (ditë në javë)	5	5	5	5	5	5
Sasia totale e mbetjeje urbane	2500	2500	1400	1000		



Më poshtë paraqiten ne forme grafike disa te dhena te sherbimit.

📌 *Sasia totale e mbetjeve urbane*


Të dhënat për sasinë totale të mbetjeve urbane në Bashkinë Libohovë tregojnë një nivel zbrites. Në vitin **2022**, sasia totale e mbetjeve ishte 2500 ton. E njëjta sasi mbetjesh është edhe për vitin 2023. Viti 2024 shenon rënie të totalit të mbetjeve deri në 1400 ton dhe pason serish me rëndësi zbrites edhe për vitin 2025, ku totali i mbetjeve arrin deri në 1000 ton. Shifrat që vijnë gjithmone në ulje mund të reflektojnë një përpjekje për menaxhimin më të mirë të mbetjeve urbane. Por kjo mund të lidhet me faktorë si rënia e numrit të popullsisë ose ndryshimet në konsumin e komunitetit. Një analizë më e thellë mbi faktorët që kontribuojnë në këto shifra do të ishte e nevojshme për një kuptim të plotë.





* Siperfaqe e mbuluar me sherbimin e menaxhimit te mbetjeve ne km2.

Te dhenat e mbledhura nder vite tregojne se ne vitin 2022 sip qe mbulohej me sherbimin e mbetjeve ishte vetem 50 km2. Ne vitet ne vijim duke nisur me 2023 kjo siperfaqe ka shkuar ne 103 km2 dhe e njejta shifer eshte mbajtur konstante edhe per vitet pasuese. Pra aktualisht mbulohet me kete sherbim pothuajse gjysma e territorit te bashkise Libohove.





Përkujdesi Social

Shërbimi përfshin dhënien e përfitimeve në para dhe në natyrë për familjet me fëmijë, duke përfshirë pagesa për nëna, grante për lindje, mbështetje për kujdesin e fëmijëve dhe pagesa periodike ose të menjëhershme për të ndihmuar familjet në përballimin e kostove specifike, si ato të energjisë, ujit dhe shërbimeve sanitare. Përfshihet gjithashtu ndihma për kujdestarët e fëmijëve, strehimi dhe ushqimi për fëmijët dhe familjet (jetimore, familje kujdestare etj.), si dhe dhënia e mallrave dhe shërbimeve për familjet, të rinjtë dhe fëmijët. Shërbimi mbulon gjithashtu përfitimet në para dhe natyrë për personat në rrezik për përjashtim shoqëror, përfshirë personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantët, refugjatët, viktimat e dhunës dhe abuzuesit e substancave, duke përfshirë kompensimin e pagave, strehimin afatshkurtër dhe afatgjatë, vakte ushqimi, këshillim, ndihmë për kryerjen e punëve të përditshme dhe furnizim me ushqim, veshje ose lëndë djegëse. Shërbimi mbështetet nga fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesave për personat me aftësi të kufizuara, dhe përfshin administrimin, organizimin dhe mbështetjen e skemave të mbrojtjes shoqërore."





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Shërbimi për personat e sëmurë dhe invalidë ofrohet sipas standardit kombëtar ligjor	Përfitimi monetar në Lekë për çdo person të sëmurë ose invalid	120.653,833 leke	108.625,476	105.670,049	141.581,456	142.021,2	



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Fondi buxhetor për invaliditetin dhe paafësinë në lekë	25.940.574	27.373.620	25.783.492	22.369.870	2.2723.392	
Numri total i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	7	7	5	6	7	
Inspektime të kryera për ndihmën ekonomike	14	14	10	12	14	
Numër personash të asistuar me pagesë invaliditeti dhe paafësie	215	252	244	158	160	
Inspektime të kryera për PAK			215	200	210	
Fondi buxhetor për ndihmën. lekë	891589	935499	808252	688963	749600	



Më poshtë paraqiten të dhënat e shërbimit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

✚ *Fondi buxhetor për invaliditetin dhe paaftësinë në lekë*

Të dhënat e fondit buxhetor për invaliditetin dhe paaftësinë për vitin **2022**, tregojnë se fondi ishte në vlerën 25,940,574 lekë. Në vitin **2023**, fondi u rrit në **27,373,620** lekë. Për vitin **2024**, fondi pësoi një ulje, duke arritur në **25,783,492** lekë. Viti 2025 vazhdon të jetë me rënie të vlerës deri në 22,369,870 lekë. Ndërsa për vitin 2026 vlera është 22,723,392 lekë. Reduktimi i fondit buxhetor për vitin 2025 vjen si rezultat I pagesës së invalideve të punës direkt nga sigurimet shoqërore, pra pagesa e tyre nuk kalon me nepermjet bashkise.




✚ *Numër personash të asistuar me pagesë invaliditeti dhe paaftësie*

Të dhënat e bashkisë Libohovë për asistencën me pagesë invaliditeti dhe paaftësie tregojnë disa prirje të rëndësishme në vitet e fundit. Në vitin **2022**, numri i personave të asistuar ishte **215**. Në vitin **2023**, ky numër u rrit në **252**. Për vitin 2024 numri arriti në 244 persona. Në vitin 2025 kemi një rënie deri në 158 persona, por kjo ndodhi sepse pagesa e paaftësisë për një kategori të caktuar invalidesh kaloi në sigurimet shoqërore. Pra nuk kemi të bëjmë me një mos efikasitet të bashkisë në monitorimin dhe ofrimin e shërbimeve për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.




NUMER PERSONASH ME PAGESE INVALIDITETI DHE PAAFTESIE.





Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime

